



PREFEKTURA DIBËR

Ardharr

Nr. 315 dt 09.04.24

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

1324  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Peshkopi, më 09.04.2024

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.28

**Datë:** 05.04.2024

**“Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkive Mat, Klos, Bulqizë dhe Dibër”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**



Ilir Elezi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.315/ 1 prot.

Peshkopi, më 11.04.2024

Lenda : Për vendimin e këshillit të bashkisë Dibër Nr.28 datë 05.04.2024

Drejtuar: BASHKISË DIBER

**DIBER**

Në mbështetje të ligjit nr.107, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e këshillit të bashkisë Dibër, Nr 28 datë 05.04.2024 "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe bashkisë Mat, Klos, Bulqizë dhe Dibër" konstatova se;


Vendimmarrje të kësaj natyre sikundër vendimi objekt shqyrtimi bëjnë pjesë në fushën e kompetencave të organit ekzekutiv të bashkisë Dibër, si organ ky i pajisur me tagrin e përfaqësuesit në marrëdhënie me palët e treta.

Duke mos qënë akt nënligjor normative, vendimi Nr. 28 datë 05.04.2024 në kuptim të ligjit 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" një vendimmarrje e tillë nuk kushtëzohet nga firma apo kundërfirma e Prefektit për hyrjen në fuqi. Siç është vendosur edhe në aktmarrëveshjen e bashkëlidhur vendimit hyrja në fuqi e akteve të tilla bëhet me nënshkrimin e tij nga palët nënshkruese siç përcaktohet në Kodin Civil mbi të cilën është hartuar kjo marrëveshje bashkëpunimi.

Shprehim dakortësinë për vijimin e procedurave të mëtejshme në realizimin e marrëveshjes të bashkëpunimit në funksion të projektit me FSHZH-në për hapjen e rrugëve rurale dhe turistike (rrugët e bardha) nëpërmjet ngritjes së operatorit të përbashkët, veprime që kurdoherë janë nën përgjegjësinë e strukturave të posaçme të bashkisë Dibër.

P R E F E K T I

- Nexhbedin SHEHU -





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 28 Datë 05 / 04 /2024

**“Për miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkive Mat, Klos, Bulqizë dhe Dibër”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 659 dhe 660 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.10130 datë 11.05.2009 “Për fondin Shqiptar të Zhvillimit”, i ndryshuar, ligjin nr.102/2020 “Për zhvillimin Rajonal dhe Kohëzisionin”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 05.04.2024, me 20 vota pro, 3 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Bashkive Mat, Klos, Bulqizë, Dibër, me objekt “Rregullimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve mes palëve në funksion të realizimit të projektit për hapjen e rrugëve rurale dhe turistike (rrugët e bardha), në qarkun e Dibrës, nëpërmjet ngritjes së operatorit të përbashkët.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Dibër.
3. Vendimi hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
4. Vendimi u shpall me datë 05.04.2024.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Irimi Shehu

